



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ - DEGA E GJYKATËS KAÇANIK

Numri i lëndës: 2022:059291

Datë: 08.03.2024

Numri i dokumentit: 05426407

P. 2022:059292

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ - DEGA KAÇANIK, Gjyqtari Burim Çaka, me procesmbajtësen Indira Beqa, në çështjen penale kundër të pandehurit R.K, i shpallur fajtor për veprën penale Vjedhja nga neni 315 paragrafi 1 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore Ferizaj PP/II.nr.367/2022 të datës 28.03.2022, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor, publik më datë 29.02.2024, në praninë e Prokurori të Shtetit Ardian Emini, të pandehurit, mori dhe publikisht shpalli, ndërsa më datë 08.03.2024 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri: R.K i lindur me datë ... nga i ati S... e ëma I... e gjinisë Ç... me vendbanim në Lagjen e re në rrugën “...” Komuna Kaçanik, me numër personal..., ka të kryer shkollën e mesme, i martuar, prind i katër fëmijëve, pensionist, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

Me datë 16.03.2022, rreth orës 16:30, në vendin e quajtur “Rruga e Çakajve”, i pandehuri, i pajisur me sharrë motorike dhe një traktor ..., me rimorkio, me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm të pasurisë së huaj për vehte, është takuar duke prerë 15 copë drunjë të llojit të bungut, me dimensione: të gjata 5 metra, me diametër 13 cm, të cilat më pas i kishte prerë në copa të vogla, duke u bërë gati për ti transportuar, por në atë moment vërehet nga rojtarët e

pyellit, dëshmitarët N. K. dhe Sh. K., të cilët edhe e përpilojnë fletëparaqitjen nr.50/2022 të datës 18.03.2022 dhe drunjët e prera i ka marrë me vehte. Me këtë veprim i ka shkaktuar të dëmtuarës Drejtorisë për Bujqësi, Zhvillim Rural dhe Pylltari-sektori Kaçanik dëm material.

- Me këtë veprim ka kryer veprën penale Vjedhja nga neni 315 paragrafi 1 të KPRK-së.

Duke u bazuar në dispozitën e lartcekur dhe nenin 2, 17, 39, 40, 42, 43, 47, 48, 49, 69, 70, 71 dhe 72 të KPRK-së dhe nenit 359, 360, 361, 365 dhe 453 të KPPK-së i shqipton:

DËNIM ME KUSHT

I. Dënim me gjobë prej 100€ (Njëqind euro) dhe dënim me burgim prej 30 ditëve (Tridhjetë ditëve), të cilat dënime nuk do të ekzekutohet në qoftë se i pandehuri në afat prej 1 viti nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nuk kryen ndonjë veprë tjetër penale, në të kundërtën gjykata do t'i revokon dënimin me kusht.

II. Pala e dëmtuar për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil.

III. Obligohet i pandehuri që në emër të shpenzimeve procedurale dhe paushallit gjyqësor, t'i paguaj kësaj gjykate shumën prej 20.00€ dhe në emër të Fondit për Kompensimin e Viktimave të Krimit të paguaj shumën prej 20.00€, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore Ferizaj ka ngritur aktakuzën PP/II.nr.367/2022 të datës 28.03.2022, kundër të pandehurit R.K, për shkak të veprës penale Vjedhje e pyllit nga neni 349 paragrafi 1 të KPRK-së, dhe ka propozuar që të pandehurin ta shpall fajtor dhe t'i shqiptohet sanksioni penal konform ligjit në fuqi, po ashtu ka propozuar që t'i shqiptohet masa e trajtimit të detyrueshëm psikiatrik në liri.

Gjykata duke vepruar sipas kësaj akuze caktoi dhe mbajti seancën e shqyrtimit fillestar më datë 29.02.2024.

Në këtë seancë Prokurori i shtetit para fjalës përfundimtare ka deklaruar se pas dëgjimit të dëshmitareve rojeve të natyrës N. K. dhe Sh. K. lidhur me përshkrimin e gjendjes faktike në vendin e ngjarjes të cilët deklaruan se kanë hasur të pandehurin në vendin e ngjarjes kanë bërë numërimin e trungjeve por se kanë vërtetuar se në rimorkion e traktorit të të pandehurit kanë qene të ngarkuar një sasi drusore rreth 20 drunjëve, mirëpo nuk kanë mundur të saktësojnë se sa ka qene vëllimi i drunjëve, po ashtu kanë deklaruar se i pandehuri në vendin e ngjarjes ka pasur me vete edhe sharrë motorike e gjithashtu kanë pohuar se përveç të pandehurit sasinë drusore apo në trungjet e numëruara prej 250 kanë mundur të prehen edhe nga dikush tjetër e jo vetëm nga i pandehuri i cili ka qene i vetëm në vend të ngjarjes në ditën kritike. E po ashtu edhe nga deklarata e vet të pandehurit R.K i cili deklaroi se është e vërtetë se ka qene në vend të ngjarjes ka prerë me sharrë motorike 15 cope drunjë të cilat i ka bartur dhe i ka shfrytëzuar të njëjtat e gjithashtu ka qene në dijeni se drutë i prera është duke i prerë në pronën publike – në pronën e huaj dhe me qenese nuk është vërtetuar saktësisht se sa ka qene vëllimi i përgjithshëm i sasive drusore të prera dhe të bartura nga i pandehuri andaj ndaj të lartë cekurave me lartë beje *rikualifikimin e veprës penale nga vepra penale vjedhja e pyllit nga neni 349 paragrafi 1 të KPRK-se në veprën penale vjedhja nga neni 313 paragrafi 1 të KPRK-se* duke pasur parasysh se i pandehuri ka pohuar edhe vete se ka marrë sasinë drusore prej 15 drunjeve me qëllim të përvetësimit të pronës së huaj saktësisht pronën e DBZHR-se Komuna e Kaçanikut.

Pas këtyre ndryshimeve faktike të aktakuzës dhe rikualifikimit të veprës penale *nga vepra penale vjedhja e pyllit nga neni 349 paragrafi 1 të KPRK-se në veprën penale vjedhja nga neni 313 paragrafi 1 të KPRK-se*, i pandehuri e ka pranuar fajësinë për të gjitha pikat e aktakuzës dhe gjatë fjalës përfundimtare ka kërkuar falje pasi që është hera e parë dhe i ka premtuar gjykatës se me nuk do të përsëris vepra të tjera penale.

Prokurori i shtetit gjatë fjalës përfundimtare ka deklaruar se mbetem në tërësi pranë aktakuzës kundër të pandehurit R.K për veprën penale vjedhja nga neni 313 paragrafi 1 i KPRK-se, nga se nga provat personale të administruara siç janë deklarata e dëshmitarëve N. K.dhe Sh. K. por edhe nga vete deklarata e të pandehurit R.K pa mëdyshje u vërtetua se i pandehuri me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm pasuror ka prerë me sharrë motorike dhe bartur 15 copë drunjë në vendin e quajtur rruga e Qakojve, pronë e DBZHR-se Komuna e Kacanikut. andaj duke marrë

parasysh te cekurat me larte propozoj gjykatës qe i akuzuari te shpallet fajtor dhe ti shqiptoj një dënim te paraparë sipas kodit penal për veprën penale për te cilën akuzohet, me rastin e matjes dhe shqiptimit te dënimit si rrethanë lehtësuese te merret pranimi i fajësisë dhe se i pandehuri është ndeshur për here te pare me ligjin ndërsa si rrethanë renduese te merret parasysh se kjo vepër penale është duke u shfaqur si dukuri.

Vlerësimi i pranimit të fajësisë

Pasi që i pandehuri e ka pranuar fajësinë gjatë përfundimit të shqyrtimit gjyqësor, pas administrimit të të gjitha provave, gjykata për të vlerësuar pranimin e fajësisë është në përputhje të plotë me të gjitha provat e administruara si: Dëshmia e dëshmitarëve N. K. dhe Sh. K. të dhënë në shqyrtim gjyqësor, fletëparaqitja e rojës së pyllit me numër të ditarit 50/22 të datës 18.03.2022.

Duke vlerësuar në aspektin e figurës së veprës penale gjykata gjeti se në veprimet e të pandehurit plotësohen gjitha tiparet objektive dhe subjektive të veprës penale Vjedhje e pyllit nga neni 349 paragrafi 1 të KPRK-së, në mënyrë kohë dhe vend si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

Rrethanat për matjen e dënimit

Me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit për të pandehurit, gjykata vlerësoj rrethanat në kuptim të nenit 69, 70 të KPRK-së, si rrethanë posaçërisht lehtësuese gjeti se i pandehuri e ka pranuar fajësinë, shprehjen e pendimit për veprën e kryer, premtimin se nuk do të përsërisë vepra penale, dhe se ka qenë hera e parë që ka kryer vepër penale, ndërsa përveç veprimeve të cilat plotësojnë figurën e veprës penale, rrethanë renduese nuk gjeti.

Sipas vlerësimit të Gjykatës dënimi i shqiptuar ndaj të pandehurit, duke i marr parasysh rrethanat e përmendura më lartë është dënim i drejtë dhe në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë së të pandehurit.

Gjykata, të pandehurit i shqiptoi sanksionin penal duke e marrë për bazë minimumin dhe maksimumin dhe qëllimin e dënimit dhe duke u bazuar në rrethanat lehtësuese ka vlerësuar se edhe me një dënim të tillë, do të arrihet qëllimi i përgjithshëm i dënimeve i paraparë në nenin 38 të KPRK-së, përkatësisht dënimi i shqiptuar është plotësisht i justifikueshëm, në përshtatje me rrethanat e kryerjes, rrezikshmërinë e saj dhe të autorit të saj, që do të shërbej në parandalimin e kryesve nga kryerja e veprave penale në të ardhmen (preventiva speciale) si dhe do të arrihet qëllimi i përgjithshëm i dënimit.

Kërkesat pasurore juridike

Duke u bazuar në nenin 462 të KPP-së, pala e dëmtuar për realizimin e kërkesës pasurore juridike është udhëzuar në kontest civil.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale

Gjykata vendimin mbi shpenzime e procedurës dhe paushallit gjyqësor e mori konform neneve 450 dhe 452 të KPPK-ës.

Gjykata vendimin mbi Kompensimin e Viktimave të Krimit e mori konform nenit 36 paragrafi 3 pika 3.1 të ligjit Nr. 08/L-109 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Mbi bazën e të dhënave si më lartë, në bazë të neneve 242 dhe 364 të KPPK-së, u vendos si n dispozitivin e këtij aktgjykimi

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Dega në Kaçanik

P. 2022:059292 datë: 08.03.2024

Procesmbajtësja
Indira Beqa

Gjyqtari:
Burim Çaka

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi mundet të ushtrohet ankesë në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate.